

## ITALIAN NEOREALISM

Të Martat e Janarit të vitit të ri 2014, **Movie Night**, do të na presin me prezantimin e Neorealizmit Italian. Çelja bëhet më datë 07/01/2014 në orën 19:00 me një prezantim të lëvizjes neorealiste nga një dokumentar i shkurtër (Anglisht) dhe katër filma nga Roberto Rossellini e Federico Fellini.

Neorealismi i përket një epoke midis masakrave dhe progreseve, të shekullit të luftimeve dhe të totalitarizmave. Lind nga një situatë e dërrmuar prej luftës së dytë botërore, ku kultura ka dështuar. Kinemaja Neorealiste rikthen ose mendon t'i rikthejë artit një rol për të shpëtuar njeriun, taman aty kur ky ka prekur pikën më të errët të civilizimit të tij. Neorealizmi, për *Roberto Rossellini*-n (një regjizor kyç i kësaj lëvizje), është një mjet për të përballuar jetën e vërtetë dhe për t'iu afruar sa më shumë gjërave të vërteta.

### E Martë 07/01/2014

**Ora 19:30** Documentary, 20 min, *Neorealism - Texture Films, INC. in cooperation with Rai*

**Ora 20:00** Film, Dram., 103 min, *Roma città aperta (Rome Open City) 1945*

**REGJIA:** Roberto Rossellini

**AKTORË:** Anna Magnani, Aldo Fabrizi, Marcello Pagliero, Maria Michi, Harry Feist, Giovanna Galletti, Francesco Grandjacquet, Nando Bruno, Vito Annichiarico

Në Romën e 1943-44, e pushtuar nga nazifashistët, luftimi, dhimbjet, sakrificat e njerëzve tregohen nëpërmjet ngjarjeve të një gruaje të thjeshtë, të një prifti dhe të një inxhinjeri komunist: gruaja vritet nga një breshëri automatiku; inxhinjeri vdes nga torturat; prifti ekzekutohet në agim në një periferi të Romës, i përshëndetur nga fëmijët e famullisë së tij. Xhiruar ndërmjet vështirësive ekonomike dhe organizative të shumë llojeve, filmi kushtëzoi në të gjithë botën një vizion dhe raprezentim të gjërave në mënyrë të vërtetë dhe të re, të cilit kritika pak më vonë do t'i jepte emrin Neorealizëm. Pasqyrë e të vërtetës ashtu siç kapet nga kamera në zhvillim e sipër, duket sot si një vepër hibride në të cilën e reja bashkëjeton me të vjetrën, shkëndijat e mëdha të së vërtetës me momente të një mënyre romanceske, gati një lirizëm epik apo një retorikë populiste. Lufta antifasciste tregohet duke theksuar më shumë anën morale se sa atë politike, gjë e cila nuk e pengoi të ishte filmi i duhur në moentin e duhur dhe të tregonte nëpërmjet figurave të komunistit dhe priftit të famullisë temën kryesore të Italisë pas-lufte. Një sukses i madh ndërkombëtarisht, shumë çmime dhe një *nomination* për *Oscar* të skenarit firmosur nga *R. Rossellini, Sergio Amidei* dhe *Federico Fellini*.

### E Martë 14/01/2014

**Ora 19:30** Film, Dram., 75 min, *Germania, anno zero (Germany, Year Zero), 1948*

**REGJIA:** Roberto Rossellini

**AKTORË:** Franz Gröger, Edmund Meschke, Barbara Hintz, Ingetraud Hintze

Në Berlinin e '46-ës, i shkatërruar nga bombardimet dhe mjerimi, një djalosh që mban të gjithë familjen vret nga dëshpërimi babain dhe gjithashtu vetëvritet. Portreti i një shteti të gjunjësuar nëpërmjet dëshpërimit të një të pafajshmi. Në itinerarin e *R. Rossellini*-t është një vepër midis neorealizmit social dhe vëmendjes mbi dramën egzistenciale të individit. Shëtitja e djelmohit ndërmjet një Berlini të pamëshirshëm dhe të tronditur është një faqe e madhe e kinemasë. *Carlo Lizzani* bashkëpunoi në skenar dhe u përdorën shumë aktorë jo profesionistë. Titulli është marrë nga *L'année zero de l'Allemagne* e *E. Marin*. Ka marrë çmim në *Festival di Locarno*.

### E Martë 21/01/2014

**Ora 19:30** Film, Dram., 96 min, *Europa '51, 1952*

**REGJIA:** Roberto Rossellini

**AKTORË:** Ingrid Bergman, Alexander Knox, Ettore Giannini, Giulietta Masina

E tronditur nga vetëvrasja e djalit të saj dymbëdhjetë vjeçar, gruaja e një diplomati më parë i afrohet marksizmit dhe pastaj fesë, duke iu kushtuar bamirësisë dhe duke u larguar nga mjedisi i saj derisa e fusin në psikiatri. Bashkë me filmat *Stromboli* dhe *Viaggio* është pjesë e trilogjisë *Rossellini*-ane të grave të shqetësuara që kanë të përbashkët vetminë. I planifikuar në rrugën e tij ideologjike, edhe për shkak të një skenari (me 7 nënshkrime) të ngurtë e demonstrues, përvoja e hidhur e *Irene*-s është të themi më mirë e "thatë" dhe skematike, edhe pse ndriçohet nga çaste intensive.

**E Martë 28/01/2014**

**Ora 19:30 Film, Komedi, 127 min, *Roma (Fellini's Roma), 1972***

**REGJIA: Federico Fellini**

**AKTORË: Peter Gonzales, Fiona Florence, Britta Barnes, Alberto Sordi, Marcello Mastroianni, Alvaro Vitali, Fëdor Scialipin**

Një portretizim i llahtarshëm, largpamës, me bloqe sekuencash gati autonome, me në bazë një inspirim autobiografik, mbi Romën e fashistëve të viteve '30-të, e parë nëpërmjet kujtimeve të *Moraldo-Fellini*, dhe mbi atë të viteve '70-të. Pasqyrë e një marrëdhënie të brishtë dhe të shpifur të *Fellinit* me *Roma-città-donna*. Është një dokumentar i mrekullueshëm ku gjithçka shndërrohet në spektakël, festë, makina, edhe pse nga shenja dhe imazhe vdekjeje. Me siguri nuk është filmi më i mirë i Federico Fellini-t, por ndoshta më i pashmangshmi.